



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 19.7.2019

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik Darjel Sina, në seancën gjyqësore të datës 19.7.2019, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 11.10.2018, është njoftuar vendimi nr. 62, datë 3.8.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim *Komisioni*), për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi vlerësoi dhe rekomandimin përkatës të paraqitur nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar ankim.

Ankimit të datës 26.10.2018 i bashkëlidhen rekomandimi i datës 10.8.2018, së bashku me anekset “A”¹ dhe “B”², si dhe denoncimi shtetasve ***.*** dhe ***.***, të dërguara pas datës së marrjes së vendimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të cilët vlerësojmë se do të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, në përmbushje të nenit Ç, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

¹ Të dhëna mbi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për adresën e vendbanimit, sipas deklaratave të dorëzuara në ILDKPKI.

² Denoncim i shtetasit ***.***.

Komisioneri Publik vlerëson se këto denoncime përmbajnë informacione që i shërbejnë vlerësimit tërësor dhe ndikojnë në procesin e rivlerësimit, brenda kuadrit të procedurës gjyqësore të apelimit dhe mbeten për t'u çmuar nga trupi gjykues i Kolegjit të Apelit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, në mbështetje të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Mbështetur në pikën 1 të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Artur Malaj ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Nisur nga rezultatet e hetimit për secilin kriter dhe nga provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, pika 1 e nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga Komisioneri Publik.

Duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, parashtrojmë si vijon:

II. VLERËSIMI DHE KËRKIMET E KOMISIONERIT PUBLIK

A. Për pasurinë “Apartament banimi”

3. Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit ka në bashkëpronësi me bashkëshorten dy pasuri, në zonën kadastrale ***, qyteti Tiranë, rruga “***.***”, si më poshtë:

- a. pasuria me nr.***, me sipërfaqe 106.7 m² (në vijim referuar “Apartament banimi”);
- b. pasuria me nr.***, me sipërfaqe 16 m² (në vijim referuar “Garazhi”);

Në D-Vett. (dorëzuar më ***.1.2017), subjekti i rivlerësimit për pasurinë “Apartament banimi”, deklaron vlerën 5.000.000 lekë, me burim kredi nga *** Bank, i likuiduar çmimi i plotë që në vitin 2005, në fazën e ndërtimit të objektit.

Në DV-2005 (dorëzuar më ***.12.2006), subjekti i rivlerësimit për pasurinë “Apartament banimi” deklaron vlerën 55.000 euro, me burim kredi nga *** Bank, në shumën 5.000.000 lekë e paguar dhe pjesa tjetër në përfundim.

4. Referuar “Rezultateve paraprake të hetimit administrativ”, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe se nuk ka burime të mjaftueshme për t'i justifikuar, në rastin më të mirë, shumën prej 15.030 euro për shlyerjen e këstit të datës ***.5.2005 dhe shumës prej 15.000 euro për shlyerjen e këstit të datës ***.7.2005. Subjekti ka paraqitur dokumentacion fiktiv me qëllim përcaktimin e vlerës së apartamentit në vlerën totale prej 5.000.000 lekë, që cenon rëndë integritetin dhe figurën e gjyqtarit. Subjekti ka kryer fshehje pasurie, duke fshehur vlerën reale të blerjes së apartamentit. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacionin përkatës.

5. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, deklarimet e subjektit të rivlerësimit në *Deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2005* (këtu e në vijim referuar si DV-2005) me *Deklaratën e pasurisë "Vetting"* (këtu e në vijim referuar si D-Vett.) dhe aktet e administruara në dosje janë të pasakta dhe të pamjaftueshme për pasurinë "Apartament banimi", për sa i përket: (i) vlerës dhe (ii) burimit të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e saj.

6. Aktet në dosje që dëshmojnë rrethanat faktike të lidhura me vlerën dhe burimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, rezultojnë sa vijon:

- a) Kontratë sipërmarrje e datës ***.5.2005, nr.*** rep, nr.*** kol., me palë sipërmarrës shoqërinë "****" sh.p.k. (në vijim ***) dhe porositës z. Artur Malaj, me objekt porosi apartamenti 117.5 m² me sipërfaqe të përbashkëta, për vlerën 61.100 euro;
- b) Kontratë shitblerje e datës ***.10.2008, nr.*** rep., nr.*** kol. me palë shitës shoqëria "****" dhe palë blerës z. Artur Malaj dhe znj.***.***, me objekt shitblerje apartamenti me sipërfaqe 106.7 m², për vlerën 5.000.000 lekë;
- c) Dokument shkresor me emërtimin "*Revokim kontrate*", i datës ***.7.2005, i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, dhe administratori i shoqërisë "****";
- d) Dokument shkresor me emërtimin "*Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim*", i datës ***.5.2008, i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, dhe administratori i shoqërisë "****".

7. Lidhur me pasaktësitë në deklaram

7.1. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasaktësitë në vlera, ka parashtruar se çmimi përfundimtar është vendosur nga palët në vitin 2008 dhe është lënë 5.000.000 lekë. Për të dëshmuar këtë rrethanë, subjekti ka paraqitur dy dokumente shkresore: (1) "*Revokim kontrate*", i datës ***.7.2005, paraqitur në Komision, pas kalimit të barrës së provës më datë ***.7. 2018 dhe (2) "*Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim*", i datës ***.5.2008, si dokumentacion shoqëruar i D-Vett., dorëzuar pranë ILDKPKI-së.

7.2. Lidhur me dokumentin shkresor "*Revokim kontrate*", i datës ***.7.2005

7.2.1 Nga përmbajtja e këtij dokumenti, rezulton se më datë ***.7.2005, subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, në cilësinë e porositësit, dhe shoqëria "****", në cilësinë e sipërmarrësit, kanë rënë dakord të konsiderojnë pa efekt dhe të zgjidhur kontratën e sipërmarrjes së datës ***.5.2005, duke hequr dorë nga çdo pretendim dhe detyrime që rrjedhin prej saj, për shkak se subjektit të rivlerësimit, z. Malaj, nuk i është disbursuar kredia që do të merrte pranë *** Bank.

7.2.2. Në vlerësim të Komisionerit Publik, ky dokument shkresor nuk ka vlerë provuese, si nga ana e përmbajtjes për rrethanat dhe faktet që paraqet, edhe nga ana formale e përpilimit të tij, për arsytet në vijim:

7.2.2-1 Ana e përmbajtjes

- Shkak për revokimin e kontratës së datës ***.5.2005, është cituar mosdisbursimi i kredisë në favor të subjektit të rivlerësimit, z. Malaj;
- Nga aktet në dosje, fashikulli i bankës *** rezulton se deri në datë ***.7.2005³, subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, ka qenë në fazën e përgatitjes/plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm të kërkuar nga banka, ku si pjesë e dokumentacionit që ka shërbyer për përfitimim e kredisë është

³ Shihni aktet shoqëruese për marrjen e kredisë në fashikullin e Bankës ***, si vërtetime, certifikatë familjare etj..

edhe kontrata e sipërmarrjes e datës ***.5.2005. Pra në datën ***.7.2005, kur pretendohet revokimi i kontratës së sipërmarrjes, subjekti ka qenë në fazën e grumbullimit të dokumentacionit përkatës për të lidhur kontratën e huas dhe nuk rezulton të ketë pasur refuzim të *disbursimit (lëvrimin) të kredisë*;

- Në DV-2005, e përgatitur dhe dorëzuar në ILDKPKI, nga subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, më datë ***.12.2006, me tepër se 1 vit nga data ***.7.2005, kontrata e sipërmarrjes e datës ***.5.2005 deklarohet si akt i prenotimit të apartamentit, pra si akt që prodhon efekte të plota dhe jo sikurse paraqitet në dokumentin (1).

7.2.2-2 Ana formale

- Dokumenti shkresor “Akt revokimi” është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, në Komision, pas kalimit të barrës së provës më datë ***.7.2018 dhe mban datën ***.7.2005. Duke qenë se përmbajtja e tij lidhet me efektet që prodhon akti, që parashtron se revokohet (kontrata e sipërmarrjes), duhej të lidhej në të njëjtën formë e mënyrë sikurse akti që revokon, pra pranë një zyre noteriale, në respektim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet se: “*Aktet zyrtare që përpilohen nga ...personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet, që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar*”.

7.2.3. Në përfundim vlerësojmë se *dokumenti shkresor “Revokim kontrate”* nuk është i besueshëm, pasi nuk pasqyron rrethanat faktike lidhur me efektin e kontratës së sipërmarrjes së datës ***.5.2005 dhe përmban deklarime të pavërteta, me qëllim paraqitjen fiktive të realizimit të pagesave për pasurinë “Apartament banimi”.

7.3. Lidhur me dokumentin shkresor “*Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim*”, i datës ***.5.2008.

7.3.1. Ky dokument shkresor paraqet si shkaqe për uljen e çmimit të pasurisë “Apartament banimi”, nga vlera 6,711,100⁴ (gjashtë milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind) lekë në 5.000.000 lekë, arsyet sa vijon:

- a) sipërfaqja e apartamentit duhej të ishte 117.5 m², është 106.7 m², pra 10.8 m² më i vogël;
- b) sipërfaqja e garazhit duhej të ishte 16 m² dhe i mbyllur, është pa mure rrethuese dhe qepena;
- c) banesa duhej të dorëzohej e përfunduar në maj 2006 dhe në muajin maj 2008 ende nuk është përfunduar.

7.3.2. Shkaqet e cituara “a” dhe “b” nga ballafaqimi me aktet në dosje nuk qëndrojnë për arsyet në vijim:

- Shkaku “a”, referuar planvendosjes së apartamentit ***, pjesë e dokumentacionit të regjistrimit në ZVRPP Tiranë, sipërfaqja e shfrytëzimit është 106.7 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 117.5 m², pra nuk ka sipërfaqe më të vogël të apartamentit;

- Shkaku “b”, referuar kontratës së sipërmarrjes së datës ***.5.2005, nuk ekziston porosia për garazh, por vetëm për apartament.

⁴ Kundërvlera në lekë e shumës 55.000 euro, e konvertuar me kurs 122.02, të datës 15.5.2008, sipas burimit: arkiva e kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë.

7.3.3 Në përfundim vlerësojmë se *dokumenti shkresor “Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim”* nuk është i besueshëm, pasi nuk pasqyron rrethanat faktike lidhur me uljen e çmimit të pasurisë “Apartament banimi”, dhe përmban deklarime të pavërteta, me qëllim paraqitjen fiktive të çmimit.

8. Lidhur me burimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë

8.1. Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit në DV-2003 dhe DV 2004 ka deklaruar respektivisht kursime nga të ardhurat nga puna e tij dhe të bashkëshortes, vlerat 300.000 lekë (deklaruar para *cash*) në vitin 2003 dhe 360.000⁵ lekë në vitin 2004. Në total kursimi në *cash* i deklaruar nga subjekti dhe bashkëshortja i disponueshëm në fillim të vitit 2005 rezulton në shumën 660.000 lekë. Në kontratën e sipërmarrjes së datës ****.5.2005*, neni 4, ku përcaktohen modalitetet e pagesës, thuhet se: *“...kësti i parë në vlerën 15.130 euro u pagua sot me lidhjen e kësaj kontrate”*.

8.2. Sa më sipër, bazuar në deklaratimet periodike vjetore të subjektit për vitet 2003, 2004 deri në maj 2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura/kursime të mjaftueshme të krijuara nga burime të ligjshme, për të mbuluar pagesën e shumës 15,130 euro ose 1.874.607 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatë) lekë, të likuiduar si këst i parë më datë ****.5.2005*, ditën e nënshkrimit të kontratës noteriale.

9. Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik për pasurinë “Apartament banimi” në rrugën “*.***”, Tiranë, në referencë të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë.**

B. Mbi kualifikimin si persona të tjerë të lidhur dhe justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë për shtetasit ***., ***.***, dhe ***.***.***

10. Komisioni ka kryer hetim për personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe ka evidentuar pasuri në emër të tyre, për të cilat subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barrën e provës, pasi citojmë: *“Ekziston dyshimi i arsyeshëm, nga ku duket se, me anë të burimeve financiare jo të ligjshme, Ju mund të keni kontributin kryesor në krijimin/përfitim të tyre, kjo edhe për faktin se këto dyshime konfirmohen edhe nga informacionet e dërguara pranë këtij Komisioni, nga agjencitë ligjzbatuese”*.

11. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti paraqiti prova dhe shpjegime, kundrejt të cilave Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *“këta persona të lidhur nuk janë në kushtet e pikës 4, të nenit 32, të ligjit 84/2016, si dhe ka vlerësuar se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga ana e subjektit lidhur me pasuritë e tyre duken bindëse, dhe se nuk ka dyshime se subjekti i rivlerësimit të ketë lidhje me këto pasuri”*.⁶

⁵ Kursim i deklaruar në DV 2004 nga subjekti, në vlerën 260.000 lekë, gjendje *cash*, nga shitja e automjetit dhe 100.000 lekë kursime, në *cash*, deklaruar nga bashkëshortja e tij në DV 2004.

⁶ Referohuni f. 37 të vendimit të Komisionit, arsyetim i kundërshtuar dhe më lart.

12. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shtetasit ***.*** dhe ***.*** (kunati dhe motra e subjektit të rivlerësimit) si dhe ***.*** (i nipi), duhet të cilësoheshin si *persona të tjerë të lidhur*, bazuar në nenin 32, dhe pika 14, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të lidhjes pasurore dhe afektive të subjektit të rivlerësimit me to. Kualifikimi si *persona të tjerë të lidhur*, në zbatim të këtyre dispozitave, ka qenë objekt i çështjeve të shqyrtuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, për të cilin ka vendimmarrje dhe është krijuar jurisprudencë⁷, e cila në kuptim të Komisionerit Publik gjen zbatim dhe në rastin konkret.

13. Gjithashtu, edhe rezultatet e hetimit administrativ paraqesin situata faktike dhe rrethana të mjaftueshme që, për qëllime të procesit të rivlerësimit, këta persona të cilësoheshin si *persona të tjerë të lidhur*.

13.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se shtetasit ***.*** dhe ***.*** kanë pasuri të konfirmuara nga ZVRPP Vlorë dhe Tiranë, si dhe kanë shpenzuar dhe investuar në pasuri të paluajtshme gjatë periudhës 2005-2016, në vlera të konsiderueshme. Nga bankat e nivelit të dytë konfirmohen transaksione të shumta, të kryera për periudhën deri në vitin 2017, të cilat kryesisht janë kryer nëpërmjet veprimeve *depozitime cash*, si dhe likuiditete në vlera të konsiderueshme⁸.

13.2 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se shtetasi ***.*** ka pasuri të llojit truall, të konfirmuar nga ZVRPP Vlorë, në bashkëpronësi me shtetas të tjerë. Nga kontratat e vëna në dispozicion, rezulton se shtetasi ***.***, vetëm në vitin 2013, ka shpenzuar minimalisht për blerjen e pasurive rreth 10.800.000 lekë.

13.3 Nga aktet në dosje, rezulton se shtetasit ***.*** dhe ***.*** kanë lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, pasi janë “garantor pasuror”, duke hipotekuar në favor të Bankës *** pasurinë e blerë më datë ***.7.2005, si garanci për shlyerjen e huas së marrë nga subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, në datë ***.9.2005.

13.4 Nga aktet në dosje, rezulton se shtetasi ***.*** është shitës i pasurisë së luajtshme automjet⁹, njëkohësisht i punësuar pranë zyrës së noterisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, z. Malaj, si dhe ka kryer shërbime të tjera në institucione shtetërore në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, pra ekziston një lidhje interesi në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

13.5 Nga analiza e provave të administruara në dosje të Komisionit, mbi mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur, për të justifikuar me të ardhura të ligjshme pasuritë e vëna, konstatojmë se subjekti nuk rezultoi të ketë provuar me dokumentacion të ardhurat e realizuara në justifikim të investimeve të kryera.

⁷ Vendimi nr. 9/2018 (JR), i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁸ Investime fondi *** pranë ***, nga ***.***, shuma 2,875,449 lekë; Depozitë pranë ***, në emër të ***.***, në shumën 51,354 USD; Obligacione, investuar datë ***.12.2016, shuma 50.000 euro, në emër të ***.***; Bono thesari, investuar datë ***.10.2010, shuma 1.550.000 lekë, në emër të ***.***; ***.***, rezulton se ka investuar në aksione në shoqërinë “***.***” sh.p.k. në shumën 25.000 euro, investim i kryer në ***.3.2016.

⁹ Referohuni përshkrimit më lart, lidhur me këtë automjet.

14. Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, në referencë të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë dhe të justifikojë bindshëm krijimin më të ardhura të ligjshme të pasurive të personave të tjerë të lidhur.

C. Mbi vlerësimin e rezultateve të hetimit, të kryera nga Komisioni, lidhur me pasurinë e ndodhur në lagjen “”, rruga “***”, qyteti Vlorë***

15. Komisioni siguroi informacione, të cilat hidhnin dyshime për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, konkretisht të një shtëpie 3-katëshe dhe truallit mbi të cilën është ndërtuar kjo vilë. Indiciet i përkasin tri burimeve të ndryshme: **(i)** informacion nga organi ligjzbatues¹⁰; **(ii)** informacione nga denoncimet e publikut¹¹; **(iii)** deklaramë mbi adresën e vendbanimit, të bëra ndër vite nga vetë subjekti.

16. Komisioni ka kryer hetim për këtë pasuri dhe i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, të cilat hidhnin dyshime për pasuri të fshehur.

17. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti paraqiti prova dhe shpjegime, kundërt të cilave Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *“...subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer fshehje të pasurisë në emër të personave të tjerë... Indiciet e cituara nga Komisioni mbi bazën e të cilave ishte krijuar dyshimi, u sqaruan nëpërmjet provave të marra gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet provave të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, pasi iu kalua barra e provës, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore, shpjegime që përputhen me provat e marra, si nga Komisioni, ashtu edhe ato të dorëzuara nga subjekti rivlerësimit. ...Pavarësisht se Komisioni ka mendimin se kjo pronë nga z. ***,***. është fituar në mënyrë të padrejtë, ajo që është objekt i hetimit administrativ nga ky Komision është fakti nëse subjekti i rivlerësimit ka apo jo ndikim, apo nëse kjo pronë ka qenë apo është e tij, apo e fshehur në emër të të tjerëve.”*¹²

18. Komisioneri Publik vlerëson se ky konkluzion nuk mbështetet nga sa ka rezultuar nga hetimi administrativ mbi këtë pasuri. Deklarimet e vetë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes si adresë vendbanimi të kësaj pasurie, origjina e fitimit të saj, si dhe deklaramët kontradiktore të shtetasës ***,***. tregojnë lidhje të forta të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri.

18.1 Deklarime mbi adresën e vendbanimit

18.1.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Malaj, në deklaramët periodike vjetore të pasurisë, pranë ILDKPKI-së, ka deklaruar si adresë banimi, l.”***”, rr.”***”, dhe më konkretisht në deklaramët periodike nga viti 2004 (për v. 2003) deri në vitin 2012 (për v. 2011).¹³ E njëjta adresë është plotësuar dhe nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në deklaramët periodike vjetore. Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka deklaruar se numri i telefonit fiks, i shënuar në disa prej deklaramëve periodike, i përket kësaj pasurie. Në dosjen

¹⁰ Shkresa nr.*** prot., DSIK, datë ***,5.2018.

¹¹ Denoncimet në dosjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, administruar në fashikullin e Komisionit.

¹² Vendimi i Komisionit 62/2018, faqet 28 dhe 29.

¹³ Pranuar nga vetë subjekti gjatë seancës dëgjimore.

e kredisë në “*** Bank”, në të cilën subjekti ka aplikuar dhe e ka marrë kredi në vitin 2005, ka deklaruar si adresë banimi lagjen “****”, rruga “****”, Vlorë.

18.1.2 Referuar të dhënave bankare, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të njëjtën adresë pranë *** Bank dhe *** Bank, dy institucione këto që nuk kërkojnë adresën e gjendjes civile, siç justifikon subjekti deklarin e kësaj adrese në plotësim të formularëve të ILDKPKI-së, por adresën faktike të vendbanimit. Po ashtu, nga verifikimi i të dhënave në QKB, rezulton se e njëjta adresë është deklaruar dhe nga bashkëshortja e tij për efekt regjistrimi si person fizik privat/notere në vitin 2005.

18.1.3 Subjekti i rivlerësimit ka bërë *deklarime kontradiktore mbi adresën e banimit* pasi në përgjigje të pyetësorit të parë ka deklaruar se: *nga janari 2011 deri në gusht 2011 ka jetuar në Vlorë, në banesën e të vëllait ***.***, lagja “***.***”, rruga “***.***”. Në përgjigje të pyetësorit nr.***, subjekti ka deklaruar se: *nga fundi i vitit 2008 deri në shtator 2011 ka banuar te shtëpia e vëllait, pa paguar qira. Nga shtatori 2011 e në vazhdim ka deklaruar se ka jetuar në shtëpinë në Tiranë, në adresën që më pas e ka saktësuar dhe në formularët e deklarinimit. Ndërkohë, nga dokumentacioni në dosje, rezulton se i vëllai i subjektit të rivlerësimit është bërë pronar i dy apartamenteve në lagjen “***.***”, rr. “***.***”, vetëm më *** nëntor 2011¹⁴. Komisioni duhet të kishte vlerësuar që sqarimet e subjektit të rivlerësimit nuk qëndrojnë.**

18.2 Origjina e pasurisë në lagjen “**”, rruga “****”, qyteti Vlorë**

18.2.1 Nga aktet në dosje rezulton se e drejta e pronësisë mbi këtë pasuri është fituar me parashkrim fitues, nga shtetasi ***.***, me vendimin gjyqësor nr.***, datë ***.9.2005, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Konstatohet se ky vendim përmban parregullsi sa procedurale, ashtu dhe materiale për sa është trajtuar gjerësisht në ankimin e vendimit nr. 62/2018. Gjithashtu, Komisioni është shprehur se kjo pronë është fituar në mënyrë të padrejtë¹⁵.

18.3 Deklarimet kontradiktore të shtetasit *.***¹⁶.**

18.3.1 Shtetasja ***.*** (e bija e shtetasit ***.***, dhe ish-sekretare e subjektit të rivlerësimit), e thirrur në cilësinë e dëshmitares, për të sqaruar rrethanat dhe faktet mbi origjinën e pasurisë së sipërcituar, regjistruar në emër të saj si bashkëpronare me të ëmën dhe motrën, ka bërë deklarime kontradiktore, të cilave Komisioni i referohet dhe në vendim¹⁷, konkretisht:

i. Ka deklaruar se banesa mbi këtë truall është ndërtuar në vitet 1991 - 1992, ndërkohë që babai i saj, në padinë e ngritur, ka pretenduar se kjo banesë është ndërtuar në vitin 1984.

14 Kontrata e shitblerjes nr.*** rep./ *** kol., datë ***.11.2011, blerës ***.*** dhe shitës shoqëria “****” sh.p.k. Objekt ap. me sip.45,2 m², çmimi i shitblerjes 2.600.000 lekë. 2. Kontrata e shitblerjes nr.*** rep./*** kol., datë ***.11.2011, blerës ***.*** dhe shitës shoqëria “****” sh.p.k. Objekt ap. me sip.55 m². Nuk figuron çmimi në kontratën që disponohet në dosje.

¹⁵ Referohuni f. 28 të vendimit.

¹⁶ Ish-sekretarja e subjektit të rivlerësimit, e bija e z.***.***, pronar origjinues i truallit ku ndodhet vila.

¹⁷ Referohuni f. 26-27 të vendimit të Komisionit.

ii. Ka deklaruar se nuk ka dijeni të plotë për mënyrën se si është përfituar kjo pasuri nga babai i saj, duke pretenduar se është pasuri e fituar nga gjyshi, ndërkohë që nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore lidhur me fitimin e kësaj pasurie, konstatohet se kjo shtetase është njoftuar për të marrë pjesë në seancat gjyqësore për fitimin e pronësisë, që po zhvilloheshin në Gjykatën e Apelit Vlorë në atë kohë (pas vdekjes së babait të saj).

iii. Gjithashtu, referuar kësaj dëshmie, rezultoi se kjo shtetase nuk mund të dokumentojë me burime të ligjshme këtë pasuri.

19. Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, për pasurinë në lagjen “**”, rruga “****”, qyteti Vlorë, në referencë të nenit D, pika 5, e aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në përdorim të tij.**

III. KONKLUZIONE

20. Nga sa analizuar më sipër, në vlerësim të Komisionerit Publik, rezulton se:

- Për pasurinë “Apartament banimi”, në rrugën “****.****”, qyteti Tiranë, në referencë të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë.
- Për pasuritë në emër të personave të tjerë të lidhur, në referencë të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë dhe të justifikojë bindshëm krijimin me të ardhura të ligjshme të pasurive të personave të tjerë të lidhur.
- Për pasurinë në lagjen “****”, rruga “****”, qyteti Vlorë, në referencë të nenit D, pika 5, e aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në përdorim të tij.

21. Mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, kërkojmë që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA